



Prishtinë, 20 gusht 2018  
Kodi i ZRRE: V\_1019\_2018

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe Nenit 48 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 paragrafi 1, Nenin 28 paragrafi 1 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);
- Dispozitat e Nenit 4, Neni 5, Neni 8, Neni 12, Neni 16 të Rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH);
- Dispozitat e Nenit 4, Neni 5, Neni 8, Neni 13, Neni 17, Neni 19 të Rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT);

në seancën e mbajtur më 20 gusht 2018 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. APROVOHET** – Caku i reduktimit të humbjeve dhe lakorja e humbjeve të lejuara për periudhën e dytë rregullative 2018-2022 për rrjetin e transmetimit (OST) dhe rrjetin e shpërndarjes (OSSH) që do të filloj nga niveli i realizuar i humbjeve në vitin 2017.
- II.** Në rast se humbjet e realizuara do të jenë më të vogla se humbjet e lejuara, të gjitha kursimet do të mbesin tek i licencuari, ndërsa në rast se nuk arrihet e gjithë kosto për mos arritjen e caktit do të mbulohen nga i licencuari.
- III.** Në vendosjen e caktit të reduktimit të humbjeve dhe lakores së humbjeve të lejuara, si emërues për kalkulimin e humbjeve në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes merren parasysh rrjedhat fizike të energjisë në tërë Republikën e Kosovës.
- IV.** Caku i reduktimit të humbjeve dhe lakorja e humbjeve të lejuara nuk aplikohet për sasi të energjisë së pa-faturuar në katër (4) komunat e veriut të Republikës së Kosovës.
- V.** Humbjet e lejuara në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes për periudhën e dytë rregullative sipas dispozitivit nën pikën I të këtij vendimi, janë dhënë në tabelën në vijim:





Tabela 1 – Humbjet e lejuara në rrjet për periudhën e dytë rregullative

Humbjet e lejuara	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022
Lejimi i humbjeve për OST	%	1.78	1.78	1.78	1.78	1.78
Caku i reduktimit të humbjeve	%	-	-	-	-	-
Lejimi i humbjeve për OSSH	%	18.80	18.80	17.60	16.40	15.10
Caku i reduktimit të humbjeve	%	-	-	1.20	1.20	1.30

## ARSYETIM

- ZRRE në përputhje me përgjegjësitë e dhëna me legjislacionin e cekur në hyrje të këtij Vendimi, e lidhur me vendosjen e cakut të reduktimit të humbjeve dhe lakores së humbjeve të lejuara, ka zhvilluar një proces transparent, ku është përfshirë edhe konsultimi me palët e interesit:
- Rregullatori më datë 15 maj 2017 ka iniciuar shqyrtimin e dytë të periudhës rregullative (prill 2018- 2022);
  - ZRRE më datë 04 korrik 2017 ka nxjerrë Raport konsultativ për Cakun për reduktimin e Humbjeve, në rrjetin e Transmetimit dhe Shpërndarjes;
  - ZRRE më datë 05 prill 2018 – ka publikuar Përgjigje ndaj komenteve, të paraqitura nga palët e interesit, në lidhje me raportin konsultativ për Cakun për reduktimin e Humbjeve;
  - Me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve të energjisë elektrike, të licencuarve OST/OT dhe OSSH, Bordi i ZRRE-së ka vendosur caqe për reduktimin e humbjeve në nivele të arsyeshme të cilat sigurojnë një baraspeshë në mes të interesave të konsumatorëve dhe të licencuarve;
  - Bordi i ZRRE-së, ka marrë për bazë analizat e raportit konsultativ për cakun për reduktimin e humbjeve dhe komentet e paraqitura nga palët e interesit, shkresat e lëndës, dokumentet shtesë të palëve të interesit si dhe performancën për periudhën 2013-2017;
  - Caku i reduktimit të humbjeve dhe lakorës së humbjeve të lejuara aplikohet vetëm për pjesën e Republikës së Kosovës në të cilën të licencuarit kanë kontroll. Derisa të licencuarit nuk kanë kontrollë në pjesën veriore edhe kalkulimet për çështje tarifore të humbjeve do të bëhen me rrjedhat e energjisë pa përfshirë energjinë e pafaturuar në katër komunat veriore të Kosovës, rrjedhimisht, humbjet në vitin 2018 do të jenë 19.95%, në vend të 18.80%, kjo qasje e kalkulimit mund të vazhdojë edhe në vitet e tjera.
- VI. Vendimi nixirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



VIII. Përshtatjet për nivelin e humbjeve në baza vjetore sipas caqeve të këtij vendimi do të bëhen gjatë procesit të përshtatjeve vjetore.

IX. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut, dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes obligohen për zbatimin e këtij vendimi për periudhën e dytë rregullative 2018-2022.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Kompanisë Kosovare për Shpërndarje dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS)
- Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT) dhe
- Arkivit të ZRRE-së